

## **YMER STAFA**



Auditues në Departamentin e Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, KLSH.

Lindur në 1952. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(1976). 35 vite eksperiencë pune, nga të cilat 24 vite në KLSH. Fusha e ekspertizës: Auditimi i financave publike.

## **NEVOJA PËR NJË FRONT KUNDËR KORRUPSIONIT<sup>i</sup>**

*nga Ymer Stafa*

Kontrolli i Lartë i Shtetit është një institucion i specializuar në fushën e kontrollit mbi financat publike, i cili në veprimtarinë e tij, krahas zbatimit të objektivave të veta, për zbulimin dhe goditjen e dukurive negative, që vihen re për administrimin financiar të pronës publike dhe në fushën e zbatimit të ligjshmërisë, për përdorimin e tij në interes të shtetit, ka në qendër të vëmendjes edhe bashkëpunimin institucional me organet ekzekutive të shtetit, prokurorinë, gjykatat, ILDKP-në dhe publikun, me qëllim që të goditen elementet keqbërës dhe të merren masa për parandalimin e faktorëve, që gjenerojnë shpërdorime dhe vjedhje të pasurisë publike.

Aktualisht, ky bashkëpunim është realizuar përmes publikimit të raporteve të kontrollit, zbulimit të veprimtarisë keqbërëse dhe shkeljeve të ligjshmërisë, marrjen e masave në vend për rregullimin e gjendjes dhe dhënien e rekomandimeve për të marrë masa administrative, disiplinore dhe penale, kundrejt nëpunësve të shtetit abuzues me fondet publike. Gjithashtu me organet e prokurorisë dhe gjykatës janë ndërmarrë veprime për denoncimin dhe penalizimin e akteve, që kanë çuar në dëmtime të rëndësishme të fondeve publike, për shkak të veprimit dhe të mosveprimit të bartësve të tyre. Duke

shfrytëzuar të drejtën ligjore, KLSH gjithashtu ka rekomanduar edhe masa me karakter ligjor e organizativ, kur ka konstatuar se këto akte apo veprime, të cilat kanë sjellë dëmtimin apo përvetësimin e pronës publike, përpos të tjerash janë edhe rrjedhojë e boshllëkut apo mangësive në legjislacion dhe akte të tjera normative, që dalin për zbatimin e tyre.

Duke qenë një hallkë e rëndësishme e shtetit për kontrollin mbi financat publike, institucioni duhet të marrë pjesë duke deleguar përfaqësuesit e tij në komisionet e luftës kundër korrupsionit, që ngrenë Këshilli i Ministrave. Nëpërmjet materialeve dhe përvojës së vet kontrolluese, institucioni i KLSH-së shfaq mendime dhe bënë propozime për të marrë masa për parandalimin e veprimeve korruptive.

Në kuadër të këtyre masave, për të thelluar më tepër bashkëpunimin në luftën kundër krimit në ekonomi dhe korrupsionit, e gjykoj me interes të ndërsjellët edhe bashkëpunimin me strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

Në kushtet aktuale, për të nxitur, inkurajuar dhe zbatuar një veprim të fortë në luftën kundër korrupsionit, më tepër se kurrë, lipset krijimi i një fronti unik e të pandërprerë, në përbërje të të cilit duhet të ingranohen të gjitha strukturat e shtetit. Krijimi i strukturave të specializuara në fushën e parandalimit dhe veprimit kundër krimit në ekonomi dhe korrupsionit, krim ky që kap grupime të caktuara në administratën shtetërore, dhe në vazhdim bashkëpunimi dhe bashkëveprimi institucional për të realizuar aksione të përbashkëta kundër tij, është një mjet efektiv për të realizuar këtë qëllim.

Korrupsioni është shfaqja më adekuate e sistemeve, në të cilat shteti është njëkohësisht pronar dhe menaxhues i pronës publike. Ai është i pranishëm në të gjitha sistemet, por veçanërisht është akut në vendet që janë në fazën e transformimeve politike dhe ekonomike.

Demokracia nuk e limiton korrupsionin. Shteti me mekanizmat e tij, ligjin dhe institucionet, duhet të zhvillojnë metoda efektive për monitorimin e korrupsionit. Ky monitorim është realisht një detyrë e vështirë. Instrumentet që përdoren për kufizimin ose mënjanimin e korrupsionit janë të shumta, por kryesore janë instrumentet ligjore e institucionale, organizative e të administrimit, për ta bërë sa më efektiv luftën kundër tij. Në këtë këndvështrim çdo përpjekje për ta luftuar ose kufizuar korrupsionin me mjete të tjera ilegale, jashtë institucioneve dhe ligjeve, do të ishte pa vlerë dhe nominalisht e dështuar.

Tendenca e përgjithshme në një ekonomi tregu të hapur, me institucione e ligje, që kanë në themel nxitjen dhe përkrahjen e konkurrencës së lirë, është ndërthurja e interesave të shtetit me atë të grupimeve të caktuara sociale apo individëve të veçantë, interesa këto që në kushte e pozicione ta caktuara, shpesh janë të kundërta. Prandaj korrupsioni shfaqet si një prirje e përgjithshme, për të vënë interesat e këtyre të fundit mbi ato të shtetit ose edhe në dëm të tij.

Këtyre prirjeve u vinë në ndihmë edhe disa faktorë politikë, institucionalë e ligjorë, që në kushtet e vendit tonë, me një tranzicion të zgjatur, me institucione të brishta dhe një administratë jo plotësisht të kualifikuar, krijojnë kushte e terren të përshtatshëm për nxitjen e korrupsionit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, i ngarkuar me detyra kushtetuese e ligjore për kontrollin e përdorimit ligjor e të dobishëm të fondeve publike, ka detyrë të monitorojë, vëzhgojë e të zbulojë çdo problem apo veprim, që bie ndesh me aktet ligjore e nënligjore, me interesat e shtetit e të publikut të gjerë. Ligji e ngarkon Kontrollin e Lartë të Shtetit, që kur zbulon ose konstaton parregullsi të tilla, të mbajë qëndrimet e duhura, të denoncojë e penalizojë veprimet e

kundërligjshme dhe, sipas rastit, të rekomandojë edhe masa për përmirësimin e gjendjes.

Përvoja disavjeçare e Kontrollit të Lartë të Shtetit në fushën e menaxhimit të fondeve publike, ka treguar se dukuritë më pikante, ku edhe gjejnë terren personat e korruptuar, për të shpërdoruar ose përvetësuar pasurinë publike janë :

- Në administrimin e fondeve për shpenzimet administrative, vërehen prirje për të kryer pagesa e shërbime jashtë kompetencave e limiteve ligjore, shkelje të procedurave ligjore dhe të rregullave për administrimin e pasurisë publike, mbishpenzime në disa zëra, të cilat mund dhe duhen evituar, kryesisht për shpenzime telefonike, udhëtim e dieta, riparim automjesh, etj.

- Për prokurimin e fondeve për investime, fonde të cilat përbëjnë peshën dërrmuese të planit të buxhetit, vërehen shkelje të rënda, shpesh të rëndomta, të procedurave ligjore në organizimin e tenderave për blerje ose ndërtim. Praktika vërteton se shumë investime janë realizuar pa efektivitet, nuk janë realizuar në sasi e cilësi volumet e parapara në kontratë, përzgjidhen firma duke paracaktuar garën konkurruese, ne forma e mënyra të dyshimta. Këto veprime antiligjore, shpesh motivohen si veprime për shkak të “naivitetit”, apo “padijes” së punonjësve të ngarkuar. Nuk thellohet se prapa tyre fshihen veprime të mirëfillta e të ndërgjegjshme korruptive, të cilat ndikojnë në ecurinë e zhvillimit ekonomik dhe pasurimin e individëve apo subjekteve private, në dëm të shtetit.

- Në fushën e implementimit të burimeve financiare dhe instrumenteve ligjore për sigurimin e tyre, disa rrugë e veprime që çojnë në veprime korruptive, gjenden qysh në fazën e planifikimit të tyre, i cili shpesh bëhet me rezervë dhe përmban në vetvete evazion fiskal, e deri në veprimin apo

mosveprimin e organeve doganore e tatimore për zbatimin e procedurave, akteve dhe marrëveshjeve, që jo vetëm pengojnë evazionin por edhe ndalojnë veprimet korruptive të punonjësve dhe subjekteve, që përfitojnë nga ky shkak në dëm të shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke qenë një instrument kontrolli i shtetit , që vepron në emër dhe për llogari të tij, në themel të veprimtarisë së tij, ka pasur rritjen e integritetit dhe të pavarësisë së tij. Kjo pavarësi nënkupton që institucioni të veprojë në përputhje me ligjin dhe ti nënshtrohet vetëm atij. Në këtë kuptim, duke ruajtur pozicionin tonë kushtetues e ligjor, në kuadrin e bashkëpunimit institucional në luftën kundër korrupsionit, me institucionet shtetërore, rendis disa nga drejtimet kryesore:

**Së pari**, fusha e shkëmbimit të informacionit. Ky informacion duhet të organizohet reciprokisht. Kështu Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbi bazën e raporteve të kontrollit, për subjekte dhe individë të caktuar, ku dyshohet për korrupsion, por që zbulimi i veprimtarisë së tyre nuk është dokumentuar tërësisht, me këto materiale të njihet zyrtarisht dhe ky shërbim. Nga ana e tij, Shërbimi Informativ Shtetëror, në rrugë zyrtare, mund të informojë dhe të ngrejë probleme, të cilat mund të gjykohen të dyshimta dhe duhet një kontroll tërësor i veprimtarisë së subjektit.

**Së dyti**, shkëmbimi i përvojës së ndërsjellët. Kjo përvojë mund të përfitohet duke treguar aspekte e veprime të paligjshme të administratës shtetërore, që kanë karakter korruptim, duke u nisur nga fakti se krimi i organizuar në ekonomi, sa vjen e bëhet më i sofistikuar, i organizuar e shumëplanësh.

**Së treti**, në fushën e përsosjes dhe zbatimit të legjislacionit. Korrigjimi dhe përmirësimi i legjislacionit është një fushë sa e gjerë dhe komplekse. Këtij qëllimi duhet ti shërbejë njohja e ndërsjellët me mangësitë që shfaqen në këtë fushë dhe më pas ndërmarrja e iniciativave të përbashkëta, për të propozuar dhe bashkëpunuar me organin ligjvënës, për të bërë korrigjimet përkatëse.

Një legjislacion i përputhur, pa ekuivoqe dhe i interpretuar qartë, saktë dhe brenda kornizës kushtetuese, do të mbrojë më mirë interesat publike dhe do të shmangë hapësirat që lënë shtigje për veprime keqbërëse e korruptive, në dëm të pronës publike.

**Së katërti**, forcimi i bashkëpunimit me organet që investigojnë krimin. Bashkëpunimi i institucioneve tona me organet e prokurorisë, për ti dhënë asaj mundësi më të mëdha, për hetimin e çështjeve të denoncuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, është një rrugë tjetër bashkëpunimi. Përmes kësaj, bëhet e mundur që fajtorët të vihen me prova të sakta e të pakontestueshme para përgjegjësisë ligjore.

Korrupsioni është një nga thirrjet më të rëndësishme në kohën tonë, një sfidë që gjithsesi duhet të përballohet. Nuk ka rrugë të prera dhe përgjigje të lehta për të. Ndëshkimi i korrupsionit në një mënyrë ose tjetër, duam apo nuk duam, është bashkëshoqërues në rrugën tonë përgjithmonë.

Lufta kundër korrupsionit, sidomos tani në fazën e tranzicionit, është tepër imperativ. Kjo duhet të motivojë ndërhyrjen e shtetit, të shoqërisë civile, të medias dhe të publikut në përgjithësi, për të krijuar një front unik, i cili të kufizojë në maksimum hapësirat nga ku mund të përfitohet. Ky front nuk mund të konceptohet vetëm me iniciativa politike, siç veprohet rëndom. Aksioni kërkon ndërhyrje të thella e të pandërprera me mekanizma ligjore, institucionale të kontrollit shtetëror dhe të shoqërisë civile, për të organizuar, administruar dhe publikuar rregulla të forta, të qëndrueshme dhe transparente.

Në këtë këndvështrim e vlerësoj dhe gjykoj edhe rritjen e bashkëpunimit institucional dhe ligjor, bashkëpunim ky që në vitin e fundit është bërë më efektiv, në luftën kundër korrupsionit.

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën "Shekulli" dt. 22 Korrik, 2013